

**ANA LALAJ**

**DILEMA BRITANIKE PËR KOSOVËN: BRENDA APO JASHTË  
SHTETIT SHQIPTAR  
(1941-1945)**

Në Luftën e Dytë Botërore, krahas fuqisë njerëzore të BS dhe armatimeve luftarake të SHBA, diplomacia britanike spikati në krijimin e aleancave kundër Boshtit Nazifashist dhe në koordinimin e planeve të luftës. Winston Churchill (më tej: Uinston Çërçill) u bë promotori i Kartës së Atlantikut, gusht 1941, e më vonë i Aleancës së madhe Antifashiste, të cilën në janar të vitit 1942, presidenti amerikan Franklin D. Roosevelt (më tej: Franklin Ruzvelt), e pagëzoi me emrin “Kombet e Bashkuar”. Kauza e Aleatëve ishte lufta e përbashkët e shteteve, kombeve dhe individëve antifashistë deri në fitoren përfundimtare mbi Boshtin Nazifashist.

Shqipëria, megjithëse një nga viktimat e para të fashizmit në Evropë, nuk u ftua për të qenë firmëtare e Deklaratës së themelimit të Kombeve të Bashkuar antifashistë. Kjo do të thoshte se Shqipëria nuk ishte anëtare zyrtare e Aleancës, siç ishin p.sh. fqinjët e saj, Jugosllavia dhe Greqia, të cilat në Aleancë përfaqësoheshin me qeveritë e veta në emigracion. Në Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste, qeveria e krijuar brenda vendit ishte kuislinge, kurse në emigracion mbreti Zog nuk u njoh nga Aleatët si kryetar i ligjshëm i shtetit shqiptar. Për rrjedhojë Qeveria e Madhërisë së Tij nuk e konsideronte Shqipërinë një aleate zyrtare të saj.

**Oficerët Ndërlidhës Britanikë në Shqipëri dhe Kosova**

Sidoqoftë Koalicioni Antifashist ishte i interesuar të përfshiheshin në luftë të gjitha vendet e popujt nën pushtim dhe më gjerë. Për këtë qëllim u krijuan një varg strukturash që nxitën dhe zgjeruan rezistencën ndërkombëtare ndaj Boshtit. Në këtë kontekst u krijua dhe Ekzekutivi i Operacioneve Speciale (Special Operation Executive - SOE), që sipas Çërçillit “do të ndizte zjarr gjithë Ballkanin”. Në këto misione merrnin pjesë Oficerë Britanikë të Ndërlidhjes (British Liaison Officer - BLO), që erdhën në Ballkanin e pushtuar për të ndihmuar rezistencën e popujve në

shpinë të armikut, ndërkohë që forcat kryesore ushtarake të Kombeve të Bashkuar ishin angazhuar në teatrot e mëdhenj të luftës kundër ushtrive të Boshtit. Misionet e SOE erdhën fillimisht në Jugosllavi, Greqi, dhe në fund të prillit 1943, edhe në Shqipëri.

Dokumentet britanike dëshmojnë se në vitet e Luftës së Dytë Botërore dy ishin shqetësimet e qeverisë britanike: shqetësimi *i parë*, organizimi i luftës deri në fitore dhe shqetësimi *i dytë*, konfiguracioni politik i pasluftës. Në politikën britanike mbizotëroi logjika se fatet e luftës do të ishin përcaktuese dhe për zhvillimet e pasluftës; e për rrjedhojë qeveria britanike e moduloi veprimtarinë e saj në pajtim me interesat e luftës. Sidoqoftë në terren, veprimet ushtarakë të Londrës herë- herë iu nënrenditën interesave strategjikë, ku herë harmonizoheshin e herë kundërshtonin njëri tjetrin. Madje në Ballkan, përfaqja britanike ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Kështu në Greqi, Britania kishte interesa të drejtpërdrejtë strategjikë. Në funksion të tyre u vendosën dhe interesat ushtarakë. Ndërsa në Jugosllavi, primare ishin interesat e momentit, ata ushtarakë. Sa për Shqipërinë, pesha e saj në pikëpamje ushtarake por edhe strategjike konsiderohej e paktë, e për rrjedhojë angazhimi i qeverisë britanike jo gjithnjë ishte ai që shpresonin shqiptarët.

Oficerët ndërlidhës britanikë kishin detyrë të mblidhnin informacion për rëndësinë ushtarake të vendit ku vepronin, të organizonin sabotazhe kundër pushtuesve nazifashistë, por më kryesorja, të mbështesnin me armatime, veshmbathje, para etj., grupet e rezistencës me të cilët ata bashkëpunonin. Pra, zyrtarisht misioni i tyre ishte ushtarak dhe një BLO duhej të ishte vetëm një “ushtar”. Por BLO-të që zbarkuan në Shqipëri e kuptuan shpejt se statusi i ushtarakut të “ngurtë” shpesh kthehej në pengesë për misionin e tyre. Vështirësi për bashkëpunimin me grupet e rezistencës dhe sidomos për koordinimin e këtyre grupeve me njëri tjetrin u hasën kudo gjatë luftës. Ato më së shumti kishin të bënin me përkatësitë dhe strategjitë politike të njërit dhe tjetrit grup rezistence. Dhe mospajtimet më të shumta shënoheshin midis komunistëve dhe nacionalistëve. Por në rastin e shqiptarëve të Kosovës, problemet ishin më të thella se rreshtimet politike të çastit dhe interesat perspektivë të pushtetit. Dokumentet për punën e misioneve britanikë në Kosovë tregojnë se ata e kanë vlerësuar jo pak dimensionin historik e kulturor të kësaj popullsie, marrëdhëniet e vështira etnike dhe platformat spastruese nën pushtetin serb. Duket se kjo optikë u ka shërbyer misioneve

përgjithësisht për detyrat e tyre të luftës e sidomos për rekomandime realiste.

Dihet se çështja e Kosovës ka qenë e koncentruar në kufijtë e saj. Ajo ishte shkëputur nga trojet etnike shqiptare me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 22 mars 1913<sup>1</sup>. Pasi Shqipëria ra nën pushtim, lëvizja më e rëndësishme e pushtuesit ishte Dekreti i Viktor Emanuelit, i gushtit 1941. Më 12 gusht të atij viti, me një dekret mbretëror, pjesa më e madhe e Kosovës iu bashkua Shqipërisë Londineze të 1913-ës<sup>2</sup>. Ky projekt bashkimi u shoqërua me një varg aktesh juridikë administrativë, arsimorë, kulturorë, që gjithsesi sollën një impuls në rigjallërimin e ndjenjës kombëtare e, pse jo, shpresë në plotësimin e një aspirote të vështirë. E gjithë kjo do të thoshte se zgjidhja e pushtuesit, edhe pse e instrumentalizuar, ishte më e prekshme se premtimet e përgjithshme të Aleatëve në bazë të realizimit të së drejtës për vetëvendosje pas luftës. Këtë situatë, jo vetëm për Kosovën, po për gjithë nacionalistët shqiptarë, më shumë se e sqaroi, e ndërlikoi një deklaratë e rëndësishme e ministrit të Jashtëm britanik, Anthony Iden (më tej: Entoni Iden), në dhjetor 1942, sipas së cilës Britania e Madhe njihte Rezistencën Antifashiste të popullit shqiptar. Me atë rast, ministri Iden kishte deklaruar në Dhomën e Komuneve të Parlamentit Britanik se “Qeveria e Madhërisë së Tij e konsideron çështjen e *kufijve* të shtetit shqiptar pas lufte si një çështje e cila do të duhet të shqyrtohet në zgjidhjet e Paqes”<sup>3</sup>, pra në Konferencën e Paqes së Pasluftës. Iden e justifikoi këtë deklaratë me faktin se Britania e Madhe nuk mund të njihte kufijtë e Shqipërisë së vitit 1941, kufij të vendosur nga pushtuesit. Sipas Kartës së Atlantikut, kufijtë e rinj të krijuar nga pushtimi nuk mund të njiheshin, pasi popujt do të merreshin me problemet e kufijve duke lënë

<sup>1</sup> *British Documents on the Origins of the War, 1898-1914*, Vol. IX, The Balkan Wars, Part II, The League and Turkey, edited by G.P.Gooch, D.Litt, F.B.A., and Harold Temperley, Litt., D., F.B.A., London: Printed and Published by His Majesty's Stationery Office, 1934; Shih gjithashtu: Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1978.

<sup>2</sup> *Fletorja Zyrtare*, Nr. 129, 29 gusht 1941. Me Dekretin Mbretëror Nr. 264, dt. 12 gusht 1941-XIX, pjesa më e madhe e Kosovës u bashkua me Mbretërinë Shqiptare dhe u caktuan kufijtë e saj.

<sup>3</sup> *British National Archives, London*, Public Record Office (më tej: *PRO.*) HS 5/67. Deklaratë e ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, Anthony Eden (më tej: Entoni Iden), lëshuar në Dhomën e Komuneve të Parlamentit Britanik, më 17 dhjetor 1942.

mënjatë qëllimin kryesor të Luftës: fitoren mbi Boshtin. Por fakti që Ideni nuk u shpreh as për kufijtë e paraluftës të Shqipërisë, domethënë para vitit 1939, te nacionalistët shqiptarë por dhe te të gjithë ata që drejtonin apo merrnin pjesë në formacionet e rezistencës u perceptua si një lëshim që u bëhej ambicieve dhe presionit grek për Shqipërinë e Jugut. Dhe shqetësimi i tyre ishte i drejtë, ministri i Jashtëm britanik e kishte lënë ‘derën hapur’ për kërkesat greke ndaj Shqipërisë së Pasluftës<sup>4</sup>.

Misioni i parë ushtarak ndërlidhës britanik në Shqipëri, CONCENSUS\*, kryesohej nga major Neil London Desmond “Billy” Mclean (më tej: Neil “Billy” Maklin). Ai hyri hyri në territorin shqiptar nga Greqia, i shoqëruar nga partizanë grekë të EAM (Fronti Nacional Çlirimtar Grek - Ethniko Apeleftherotiko Metopo) dhe fillimisht mori takim me partizanët shqiptarë që vepronin në qarkun e Gjirokastrës. Më 1 maj 1943, ai i dërgoi një letër Këshillit të Përgjithshëm Nacional Çlirimtar Shqiptar, të cilit i bënte me dije statusin dhe misionin e tij si oficer ndërlidhës britanik për të vendosur lidhjen midis lëvizjes së rezistencës në Shqipëri dhe Shtabit Aleat në Kajro<sup>5</sup>. Në përputhje me detyrat e tij, ai arriti të kuptojë rëndësinë e Kosovës në suksesin e misionit të tij për të mobilizuar kundër forcave ushtarake gjermane sa më shumë shqiptarë. Për këtë qëllim, në korrik 1943, Maclean i kërkoi shtabit të Kajros ardhjen e një misioni ndërlidhës britanik edhe në Kosovë<sup>6</sup>.

Mungesën e misioneve në Kosovë e ka shënuar edhe kryeoficeri i misionit të dytë të BLO, gjenerali Edmund F. Davies\* (më tej: Edmënd Devis). Midis një varg faktorësh pengues për rritjen e ndikimit të BLO te grupet e rezistencës në Shqipëri, Devis do të përmendte dhe çështjen e Kosovës. Ai do të bënte drejtpërdrejt përgjegjëse qeverinë britanike për mosnjohjen e një qeverie shqiptare në mërgim, për trajtimin e privilegjuar

<sup>4</sup> PRO. Foreign Office (më tej: FO) 371/33108/R 8604/184/90, Letër e ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, Entoni Iden, për ambasadorin grek në Londër, M. Agnides, më 30 dhjetor 1942.

\* Çdo mision i Oficerëve Ndërlidhës Britanikë [BLO] kishte emër të koduar.

<sup>5</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh, Fondi (më tej: F.) 41, viti (më tej: V.) 1943, dosja (më tej: D.) 40, fl. 1.

<sup>6</sup> Roderick Bailey, *The Wildest Province. SOE in the Land of the Eagle*. London: Vintage Books, 2009, p. 169. (Cituar sipas: CONCENSUS to SOE Cairo, w/t message, 29 July 1943, Maclean papers, IWM).

\* Edmund F. Davies “Trotsky”, Gjeneral brigade i misionit të dytë të BLO që erdhi në Shqipëri, më 15 tetor 1943 dhe u zu rob nga pushtuesit gjermanë më 8 janar 1944.

që u bëhej Greqisë dhe Jugosllavisë në raport me Shqipërinë, për mosdhënien siguri shqiptarëve për statusin e tyre të pasluftës, një segment të të cilit ai konsideronte dhe Kosovën. Gjeneral Devis është realist në vlerësimin e tij kur përballë politikës ekuivoke të qeverisë britanike vendos pushtimin gjerman, për të cilin ai shprehet se “është shtypës, por së paku siguron mbajtjen e rajonit të Kosovës”<sup>7</sup>.

Oficeri Britanik Ndërlidhës i projektuar nga Kajro për të shkuar në Kosovë, zbarkoi në Shqipëri në gusht të vitit 1943. Ai ishte majori Peter M.M. Kemp, me misionin e koduar STEPMOTHER. Fillimisht Kemp i qëndroi në çetën nacionaliste të Pezës, që u bashkua me Shtabin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (më tej: UNÇSH), e në fund të vitit u largua për në Kosovë. Në Tiranë, në takime me njerëz nga krahina të ndryshme, me nivele të ndryshme kulturore dhe me përkatësi të ndryshme partiake, ai kuptoi vendin që zinte Kosova në historinë politike dhe ekonomike të shqiptarëve, si dhe në konstruksionin mendor e shpirtëror të tyre. Në një nga raportet e përgatitur për shefat e tij në Bari SOE, Kemp shkruante: “Nuk po e ekzagjeroj kur them se për të gjithë shqiptarët që kam takuar, Kosova përbënte një shqetësim të madh. Njerëz me pikëpamje krejtësisht të ndryshme, duke filluar nga Enver Hoxha dhe Mustafa Gjinishi, Ymer Dishnica, Vasil Andoni, Halil Maçi, të gjithë pranonin rëndësinë që kishte për Shqipërinë ndreqja e problemit të Kosovës”<sup>8</sup>. Të gjithë ata i kërkonin Kempit “të siguronte nga Aleatët një deklaratë, ku të mos thuhej që Kosova do t’i kthehej Shqipërisë, por të thuhej se e ardhmja e saj do të vendosej nga një plebishit i mbajtur nën mbikëqyrjen e Aleatëve”, ose si alternativë, “qeveria jugosllave në Londër të lëshonte një deklaratë, me të cilën do të pranonte një plebishit të tillë”<sup>9</sup>.

I ndodhur në këtë terren të ndjeshëm e plot trysni, më 29 shtator 1943, që nga Peza, majori Kemp i dërgoi një telegram shtabit të Kajros, të cilit i kërkonte të ndërhynte te qeveria jugosllave me qëllim që kjo e fundit të bënte një deklaratë, ku t’i premtonte popullit të Kosovës se ai

<sup>7</sup> PRO. HS 5/68/ B8/2/PL/70, Telegram i gjeneralit E. Devis dërguar SOE Cairo, Nr. 3138, më 17 dhjetor 1943.

<sup>8</sup> PRO, WO 204/9536/B8/1/291.

<sup>9</sup> Po aty.

“do të lihej të zgjedhë lirisht midis qeverisë jugosllave ose qeverisë shqiptare në përputhje me Kartën e Atlantikut”<sup>10</sup>.

Kërkesa e Kempit iu përcoll Komitetit të Operacioneve Speciale (SOC-Special Operation Committee), komitet i përhershëm politik që vepronte pranë Forcave Ajrore për Ballkanin (Balkan Air Force - BAF), e që shqyrtonte probleme të rëndësishme politike dhe ushtarake të luftës në Ballkan. SOC e shtroi për diskutim kërkesën e Kempit në mbledhjen e 13 tetorit 1943. “Komiteti ka përpara një material, shkruhet në regjistrimet e mbledhjes, i cili sugjeron që t’i kërkohej qeverisë jugosllave të bëjë një deklaratë që populli i Kosovës duhet të lejohet për të vendosur vetë pas luftës nëse Kosova do të jetë pjesë e Jugosllavisë apo e Shqipërisë”. Kjo kërkesë u kundërshtua nga ministri britanik pranë qeverisë jugosllave dhe asaj bullgare në Kajro, R.C. Skrine Stevenson (më tej R.C. Skrine Stivenson), i cili ishte shprehur se: “Nuk ka gjasa që qeveria jugosllave të pranojë një kërkesë të tillë, dhe as është e përshtatshme të bëhet një kërkesë e tillë. Tashmë është e qartë se çdo kërkesë lidhur me kufijtë duhet të presë deri në Konferencën e Paqes”<sup>11</sup>. Pas kësaj vërejtjeje SOC ra dakord që asnjë qasje nuk duhet bërë te qeveria jugosllave lidhur me të ardhmen e Kosovës.

Përgjigjja iu dërgua majorit Kemp nëpërmjet seksionit shqiptar në Bari, më 21 tetor 1943: “Me keqardhje [ju njoftojmë] se ideja për të marrë një deklaratë nga qeveria e Madhërisë së Tij dhe qeveria jugosllave [në Londër] për të ardhmen e Kosovës ose rajone të tjera të diskutueshme në kohën e tanishme janë absolutisht nul. Prandaj ju duhet të mbani qëndrimin se të tilla probleme janë jashtë kompetencave tuaja dhe se ju jeni të interesuar vetëm për çështje ushtarake. Këtë telegram përsëritjani gjeneralit Devis dhe Hends”<sup>12</sup>.

<sup>10</sup> *PRO. HS 5/66/B8/2/PL/238*, Telegram i Kempit (Stepmother), 29/9/43, Folio 05935.

<sup>11</sup> *PRO. WO 201/2790. S.O.C. (43) 6th Meeting*, 13<sup>th</sup> October, 1943, “Future of Kosovo”.

\*\* Arthur G. “Andy” Hands, (më tej: Artur G. “Andy” Hends) BLO, që qëndroi fillimisht në Shqipëri dhe në dhjetor 1943 kaloi në Kosovë, ku qëndroi nga data 13 korrik deri më 15 gusht 1944.

<sup>12</sup> *PRO. HS 5/66/ B8/2/PL/238. (STEPMOTHER 50 of 21 October, Folio 005217)*.

### “Deklarata” e Titos për plebishit në Kosovë

Kur Edmënd Devis u kap nga gjermanët më 8 janar 1944, këta të fundit gjetën në letrat e tij dhe telegramin e dërguar nga Kajro për oficerët ndërlidhës Kemp, Devis e Hands, ku mohohej mundësia e lëshimit të një deklaratë nga ana e qeverisë britanike për një plebishit në Kosovë. Gjermanët e përdorën me shkathtësi këtë dokument duke e shpërndarë përmbajtjen e tij me anë fletushkash në Gjakovë<sup>13</sup>, gjë që diskreditonte politikën e Aleatëve në sytë e shqiptarëve të Kosovës. Gjithashtu propaganda gjermane në Kosovë tregojë mjaft aktive në media, trakte e në postera për të ngjallur mosbesim si ndaj forcave të Shtabit të Titos ashtu dhe ndaj partizanëve shqiptarë që bashkëpunonin me të.

Ndërkohë duket se me idenë e plebshitit në Kosovë po manovronte edhe Tito. Dokumentet britanike bëjnë të qartë se ideja për plebishit ishte një projekt i hedhur enkas në qarkullim nga Shtabi i Titos, që synonte të kundërbalancoje propagandën gjermane, të mbante me shpresë shqiptarët se fatet e ardhme do të zgjidheshin prej vetë atyre, dhe ndërkohë të krijonte një mjegull të britanikët për qëndrimin e PKJ ndaj Kosovës dhe çështjes kombëtare në përgjithësi. Një informacion të mjegullt rreth një deklaratë të Titos për plebishit në Kosovë jep koloneli Vladimir Velebit, përfaqësuesi i Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave (më tej: UNÇJ) në Kajro, i cili i ka thënë majorit “Billy” Maklinn se “kjo deklaratë është arritur dhe se ai do të përpiqej t’i jepte asaj një publicitet sa më të gjerë për palën jugosllave”. Por Maclean është mosbesues ndaj fjalëve të Velebitit dhe në memorandumun e tij për Londrën, më 9 janar 1944, shkruan: “Po qe se kjo do të ishte bërë, atëherë kosovarët do të ndaheshin në mënyrë efektive nga gjermanët”<sup>14</sup>.

Njoftimin e parë për një deklaratë të Titos për të ardhmen e Kosovës e dha më 6 dhjetor 1943 oficeri i BLO në Kosovë, Artur G. Hends, i cili lajmëroi Kajron se më 4 dhjetor 1943, Shtabi i Përgjithshëm Jugosllav i udhëhequr nga Tito “kishte lëshuar një komunikatë që njihte të drejtën e

<sup>13</sup> PRO. HS 5/79/ 138/2/PL/238.

<sup>14</sup> PRO. FO 371/43549, “Memorandum për Shqipërinë” i majorit Neil “Billy” Maklin, 9 janar 1944. Është një studim prej më shumë se 40 faqesh, jo thjesht informues por edhe analitik, për forcat politike në Shqipëri, për marrëdhëniet midis tyre, për rëndësinë që ka Kosova në zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare shqiptare, për marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët etj. Ky Memorandum është analizuar hollësisht nga Prof. Arben Puto në librin e tij: *Nëpër analet e diplomacisë angleze*, Tiranë: 8 Nëntori, 1980.

kosovarëve për të zgjedhur qeverinë e tyre të pasluftës”<sup>15</sup>. Por ky raport nuk u verifikua nga Kajro, pasi ambasadori i Britanisë së Madhe pranë qeverisë jugosllave, Skrine Stevenson, ashtu edhe Steel<sup>\*\*\*</sup>, ishin “të shqetësuar” dhe mendonin se “duhej shmangur çdo veprim që mund të nënkuptojë se ne [qeveria britanike] kemi ndonjë interes për Kosovën”<sup>16</sup>. Me sa duket informacioni për deklaratën e Titos ka tërhequr vëmendjen e niveleve të larta të FO dhe të SOE, të cilët kanë përdorur kanale më të sigurta për të mësuar të vërtetën. Më 21 mars 1944, Boxshall, shefi politik i SOE për Ballkanin në FO, i shkruan Douglas Howard-it (më tej: Dagllas Houard) shefit të Departamentit të Jugut në FO, se “Gjeneral Mclean [Fitzroy]<sup>\*\*\*\*</sup> e pyeti Titon lidhur me komunikatën e lëshuar nga shtabi i tij më 4 dhjetor ... dhe se cili ishte qëndrimi i tij në të vërtetë”. Përgjigja e Titos ishte rrëshqitëse: “Populli i Kosovës, u shpreh ai, ka kërkuar autonomi lokale por AVNOJ<sup>\*\*\*\*\*</sup> ende nuk ka marrë një vendim për këtë çështje”<sup>17</sup>.

Që ideja e një deklaratë mashtruese për plebishit në Kosovë është prodhuar nga vetë shtabi i Titos, dëshmon edhe një telegram i gjeneralit Fitzroi Maklin, përcjellë Force 266, Zyrës së SOE në Bari, më 13 prill 1944. Mbështetur në dokumentet jugosllave që i ishin servirur nga shtabi i UNÇJ, Fitzroi Maklin, njoftonte për vendimet e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë të miratuara në Jajcë të Bosnjës, në nëntor 1943, ku ndër të tjera, informonte dhe për një pikë të veçantë me këtë përmbajtje: “E ardhmja e Kosovës do të vendoset me plebishit dhe

<sup>15</sup> PRO. HS 5/68, Informacioni është përmendur në telegramin Nr. 873, dërguar nga Kajro në FO, më 23 shkurt 1944.

<sup>\*\*\*</sup> Christopher “Kit” Steel, anëtar i SOC dhe përfaqësues i qeverisë britanike në Kajro për çështjen shqiptare.

<sup>16</sup> PRO. HS 5/68, Telegram Nr. 873 dërguar nga Kajro në FO, më 24 shkurt 1944. Telegrami mban titullin “Tito dhe plebishiti në Kosovë”.

<sup>\*\*\*\*</sup> Fitzroy Mclean (më tej: Fitzroi Maklin), Shef i Misionit Ndërlidhës Britanik pranë shtabit të UNÇJ.

<sup>\*\*\*\*\*</sup> AVNOJ [Antifašističko Vijeće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije - Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë]. Fjala është për mbledhjen e Dytë të AVNOJ në Jajcë të Bosnjës, më 29 nëntor 1943.

<sup>17</sup> PRO. FO 371/43550/ EGB/AI/118, Letër e Edwin “Eddie” Boxshall, shefi politik i SOE për Ballkanin në FO, dërguar Douglas Howard (më tej: Dagllas Houard), shefit të Departamentit të Jugut në FO, më 21 mars 1944.

kufijtë në qoftë se është e nevojshme, do të zhvillohen në favor të Shqipërisë”<sup>18</sup>.

Kryetarin të zyrës së SOE në Bari, Philip Broad (më tej: Filip Broud), nuk i shpëtoi kjo pasaktësi. Broud ia bëri me dije ministrit të Jashtëm, Iden, raportin e gjeneralit Maklin, por nënvizonte se “mbajtja e një plebishiti në rajonin e Kosovës, i cili do të vendosë për kufijtë e ardhshëm në favor të Shqipërisë nuk përmendet në Rezolutën e AVNOJ-t”. Dhe shtonte se po të bëhej kjo “padyshim do të ngjallehin pakënaqësi të mëdha midis serbëve, të cilët kanë lidhje të forta sentimentale me atë rajon, siç kanë pasur dikur me perandorinë e tyre mesjetare”<sup>19</sup>.

Të mos harrojmë se ideja e së ashtuquajturës deklaratë e Titos për plebishit në Kosovë, u vu në qarkullim kur KQ i PKJ më 28 mars 1944 me anën e një letre të firmosur nga Milovan Gjilas, kishte shpërfillur dhe goditur në pikën më esenciale Rezolutën e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit në Bujan, 31 dhjetor 1943- 2 janar 1944, në të cilën shprehej “aspirata shumëvjeçare e popullit të Kosovës për t’u bashkuar me Shqipërinë”, kërkohej që e ardhmja e Kosovës të vendosej “në bazë të së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje”, e rruga e vetme për këtë do të ishte “lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjakësor e rrogëtarëve të tij”<sup>20</sup>. Madje, pikërisht në këtë kohë, më 26 mars 1944, Tito nëpërmjet një letre të firmosur nga Peko Dapčević (më tej: Peko Dapçeviç), komandant dhe Mitar Bakić (më tej: Mitar Bakiç), komisar i Korpusit II<sup>21</sup> të Ushtrisë Jugosllave i kërkonin Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH ndihmë për të përballuar “reaksionin shqiptar në Veri të Shqipërisë”, ku njësitë të Korpusit të Dytë të UNÇJ u ishte dashur “gjysmë viti të mbanin front

<sup>18</sup> PRO. FO 536/12, Mesazh i shifruar, Rowene, Nr 605, 13 April 1944, B.1/B1 për Force 266, Bari.

<sup>19</sup> *British documents on Foreign Affairs: Reports and Papers from the Foreign Office Confidential Print*. Part III, From 1940 through 1945, Series F, Europe, General editors Paul Preston and Michael Partridge; editor MacGregor Knox, Volume 23, Part 10, London: University Publications of America, 1998, f. 479, Telegram Nr. 151 i Z. Filip Broud dërguar Entoni Iden, më 30 prill 1944.

<sup>20</sup> Ana Lalaj, “Konferenca e Bujanit, 31 dhjetor 1943 – 2 janar 1944, një analizë e rivlerësuar”, në: *Studime Historike*, 1-2, Tiranë: 2011.

<sup>21</sup> Korpusi II i UNÇJ konsiderohej formacioni më i rëndësishëm i Ushtrisë NÇ Jugosllave. Në vjeshtë të vitit 1943 ai depërtoi në trekëndëshin e Sanxhakut, Metohisë dhe Malit të Zi, me synimin që në të ardhmen të kryente operacione ushtarake në drejtim të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Kosovës.

kundrejt kufirit të ri<sup>\*</sup>”. Letërshkruesit kërkojnë që formacionet e UNÇSH të kalojnë në Shqipërinë e Veriut ku përfshihej dhe Kosova për të bashkëpunuar me forcat jugosllave. Sipas tyre “kjo do të kishte rezultate politike si në luftë kundra okupatorit, ashtu edhe kundra reaksionit, si sot ashtu edhe në të ardhmen<sup>22</sup>”.

### **Raporte të BLO nga Kosova: Shqiptarët nuk i besojnë politikës sonë të Pasluftës**

Raportet e parë nga Kosova për F 266 në Bari, shënohen në dhjetor të vitit 1943 nga kapiteni Hends dhe majori Kemp. Dokumentet britanike tregojnë se Hends dhe Kemp vendosën shpejt kontakte përkatësisht me partizanët dhe nacionalistët shqiptarë në Kosovë<sup>23</sup>. Hands takoi për herë të parë Fadil Hoxhën, kryetarin e Shtabit të formacioneve ushtarake të Kosovës, më 27 dhjetor të vitit 1943. Hands ishte i pranishëm dhe në mbledhjen për formimin e Këshillit NÇ në Bujan, më 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944. Për këtë ngjarje është raportuar në Bari në fillim të janarit dhe Qendra e Zbulimit Politik, Lindja e Mesme [Political Intelligence Centre, Middle East] përgatiti një përmbledhje. Nuk është shumë i qartë nëse informacioni është dërguar nga Hands apo nga ndonjë kanal jugosllav, si p.sh. nga Pavle Joviçević [Pavle Jovičević], që mund t’ia ketë përcjellë shtabit të Titos dhe ky i fundit, Misionit britanik të atashuar pranë tij. E shtroj këtë hipotezë sepse në asnjë raport ku përmendet Konferenca e Bujanit, nuk flitet për Rezolutën në mënyrë të detajuar, pra ngjarja nuk përcillet në mënyrë korrekte, siç ndodh me raportet e BLO në përgjithësi. Gjithsesi, informacioni i parë britanik që unë kam hasur për Konferencën e Bujanit dhe vendimet e saj daton më 7 janar 1944. Ai është një telegram që majori Edwin “Eddie” Boxshall (më tej: Edvin “Eddie Bokshell), nëpunës i lartë në seksionin e Zbulimit për Ballkanin, ia dërgon kapitenit Vandeleur Robinson, në seksionin shqiptar të Kajros. Në telegram shkruhej se në mbledhjen e Bujanit morën pjesë 52 përfaqësues shqiptarë, serbë dhe malazezë prej Kosovës, Malësisë së Madhe dhe rajonit të

\* Me togfjalëshin “kufiri i ri” kuptohej kufiri i Shqipërisë i krijuar pas gushtit 1941, kur Kosova u bashkua me Shqipërinë.

<sup>22</sup> Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSH), F. 41, V. 1944, D. 136, Radiogram i Peko Dapçeviçit, komandant dhe Mitar Bakçit, komisar i Korpusit II, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, Nr. 252, më 26 mars 1944.

<sup>23</sup> PRO. HS 5/68/B8/2/PL/187, Telegram i SPM Lik për qendrën e SOE në Bari (B.8 për G. OPS).

Dukagjinit. Sipas informacionit Konferenca zgjodhi të bashkohet me Aleatët dhe të luftojë në bazë të Kartës së Atlantikut. Dy delegatë do të dërgoheshin te Tito dhe dy të tjerë te LNÇ për të koordinuar veprimtaritë<sup>24</sup>. Më 20 janar, kjo ngjarje iu referua edhe më gjerësisht ministrit të Jashtëm britanik, Iden, i cili njoftoj se Konferenca kishte pasur sukses për të sjellë së bashku patriotët shqiptarë, serbë dhe malazezë dhe se ajo do të rriste bashkëpunimin mes partizanëve jugosllavë dhe shqiptarë. Gjithashtu në raport flitej edhe për bashkëpunimin midis lëvizjeve partizane të Kosovës, Jugosllavisë e të Shqipërisë<sup>25</sup>.

Që në ditët e para të arritjes në Kosovë, oficerët ndërlidhës britanikë u ballafaquan me vështirësi të shumta. Ata raportuan në Bari për situatën e veçantë politike në Kosovë dhe kërkuan udhëzime. Seksioni shqiptar në Bari i përcolli raportet në Kajro dhe kjo e fundit i quajti ato të “shkëlqyera”, por i udhëzonte “të ishin të kujdesshëm të mos kontaktonin me jugosllavët”<sup>26</sup>. Në raportet e tij, majori Kemp informonte Barin se në Kosovë sipas regjistrimit të fundit, shqiptarët e Kosovës përbënin më shumë se 75% të popullsisë; se ata ishin trajtuar nga serbët jo si minoritet kombëtar por si minoritet fetar, duke i quajtur si “myslimanë” ose “turq”, ndërsa ata gjithnjë e kanë konsideruar veten shqiptarë dhe janë me një “sentiment të fortë nacionalist”. Pavarësisht se gjuhën e tyre nuk lejohej ta mësonin në shkolla, Kemi konstaton se ata e përdorin në familje dhe ua mësojnë atë fëmijëve të tyre; ata duan një plebishit të lirë të mbajtur nën monitorimin e anglo-amerikanëve. “Shumica e tyre, shkruan Kemp, mendojnë se çdo plebishit i mbajtur nën jugosllavët, domethënë nën supervizionin e serbëve, do të kishte vetëm një rezultat, Kosovën nën Serbi”<sup>27</sup>. Sipas majorit Kemp, “shqiptarët në Kosovë ishin të tmerruar nga reprezaljet e gjermanëve, por nuk kishin besim as te partizanët e Fadil Hoxhës, të cilët bashkëpunonin me shtabin e Titos”. Kemi kishte krijuar bindjen e thellë se BLO nuk do të mundnin të kryenin asnjë aksion ushtarak në Kosovë, pa u premtuar shqiptarëve vendas një

<sup>24</sup> PRO. HS 5/68/EGB/AI/5765, Radiogram i majorit Edwin “Eddie” Boxshall për kapiten Vandeleur Robinson, më 7 janar 1944.

<sup>25</sup> PRO. HS 5/67/2/88/44, Telegram Nr. 39 i ambasadorit britanik pranë qeverisë jugosllave në Kajro, R.C.Skrine Stevenson për ministrin e Jashtëm, Entoni Iden, më 20 janar 1944.

<sup>26</sup> PRO. HS 5/79, Telegram i DD dërguar Hends dhe Kemp, më 18 janar 1944.

<sup>27</sup> PRO. HS 5/158; shih gjithashtu: PRO, WO 204/9536.

plebishit të lirë. Përgjigjja e Kajros për plebishit në Kosovë kishte qenë negative dhe majorit Kemp i ishte sugjeruar që t'i 'shmangte me takt' pyetjet konkrete për të ardhmen e Kosovës. "Por ishte krejt e pamundur t'i shmangie ato pyetje, -shkruan Kempin në raportet e veta, -pasi ato ishin në mënyrë konstante pyetjet e para që më bëheshin mua nga çdo njeri që unë takoja në Kosovë, pavarësisht nga përkatësia partiake. Unë i bija rrotull muhabetit sa mundja, duke iu drejtuar për ndihmë Kartës së Atlantikut, por megjithëse unë e shmanga qëndrimin e Qeverisë së Madhërisë së Tij në çfarëdolloj mënyre, unë nuk mund të vazhdoja të bindja kosovarët për të kaluar në anën tonë dhe të merrnin armët për ne. Ata nuk i besonin politikës sonë të pasluftës ndaj tyre ..."<sup>28</sup>

Marrëdhëniet e BLO ishin të ftohta deri të acaruar, edhe me shtabin e aradhave partizane të Kosovës. Komandanti i shtabit, Fadil Hoxha kishte pohuar se është i aftë të mbledhë 1200 burra [raportet britanike thonë se në atë kohë kishte vetëm 100 partizanë në Kosovë] nëse do të vinin armë dhe furnizime. Sipas një raporti britanik, "lëvizja e KOSMETIT\*\* kishte marrë shumë pak ndihma"<sup>29</sup>. Në një telegram tjetër,

<sup>28</sup> PRO. HS 5/144, Peter Kemp, "Raport on Albania, August 1943 - March 1944". Majori Kemp përmend në raportet e tij emra të shumtë shqiptarësh me të cilët është takuar në Kosovë dhe në Shqipëri. Jo vetëm shqiptarët e Kosovës e shihnin Shqipërinë si qendër tërheqëse që u garantonte mbijetesën, por edhe shqiptarët e Shqipërisë e shihnin Kosovën si mbijetesë ekonomike për një shtet të pavarur politikisht. Ja seç shkruan Kempin për takimin me një nga bajraktarët më në zë të Shqipërisë së Veriut, në kullën e të cilit u organizua dhe mbledhja e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit në fund të dhjetorit 1943: "Arritëm në Degë. Aty patëm paralajmërimet. Ishin ceremonitë e Bajramit të vogël, 7-9 dhjetor 1943, dhe popullsisë kishte rrezik t'u prishej festa. "Unë vendosa të kontaktoj Mehmet Hoxhën, i cili me disa shokë të tij ishte në një fshat në Veri të bregut të lumit Valbona, në shtëpinë e Sali Man Bajraktarit, një nga bajraktarët më të fuqishëm në Malësinë e Gjakovës, për të cilin unë pata një letër nga Abaz Kupi. Në mëngjesin e 8 dhjetorit, unë u nisa për në shtëpinë e Sali Manit, duke marrë Zenelin [përkthyesin] me vete, dhe arritëm sapo binte muzgu. Atje unë gjeta Sali Manin, një burrë të gjatë, me flokë të bardhë nga mosha, i cili më priti mua shumë mirë por më përsëriti disa herë se 'Aleatët nuk duhet ta shkëpusin Kosovën pas Luftës, pasi ne nuk mund të jetojmë dot pa të'. Unë gjeta atje Mehmet Hoxhën, i cili më tha se Xhafer Deva, ministri i brendshëm progjeran kishte shkuar në Pejë dy ditë më parë me 600 mercenarë fashistë nga Mitrovica; kishte pushkatuar disa njerëz e tani kishte arritur në Deçan".

\*\* Lëvizja partizane në Kosovë quhej prej oficerëve ndërlidhës britanikë "KOSMET".

që SPM Leake (më tej: SPM Like) i dërgon shtabit të Kajros më 30 janar 1944, flitet në mënyrë më të detajuar për ndihmën e pakët financiare britanike për partizanët e Kosovës, që nuk i kalonte 1000 stërlinat, madje dhe ato, në sajë të insistimit të Hands<sup>30</sup>. Në këtë situatë të tendosur, më 24 janar 1944, majori Kemp mori urdhër nga Kajro të ndërpriste kontaktet “me takt” me nacionalistët dhe irredentistët në Kosovë, me shpjegimin se partizanët jugosllavë “kishin protestuar ashpër” për veprimtarinë e tij dhe se për Kajron, “lidhjet me partizanët jugosllavë ishin jashtëzakonisht të rëndësishme”<sup>31</sup>. Një ditë më parë Fadil Hoxha kishte protestuar te Hends për oficerët Neel dhe Kemp, për shkak se shoqëroheshin me “reaksonarët”, nacionalistët e irredentistët e Kosovës dhe kishte paralajmëruar se ai ishte i detyruar të “raportonte te Marshall Tito dhe te LNÇ e Shqipërisë”. Në fakt letra e Fadil Hoxhës dërguar Enver Hoxhës, ku i kërkon të ndërhyjë pranë Misionit Britanik në Shqipëri që ky i fundit të lajmërojë Shtabin e Kajros për veprimet e britanikëve në Kosovë, të cilët shoqërohen “me bashibozukë, gjakatarë e reaksionarë dhe na pengojnë të kryejmë aksione bash në nervin kryesor të fashizmit në vendin tonë, në rrugën Shkodër-Prizren”<sup>32</sup>, ndodhet në arkivat shqiptare. Fadil Hoxha pohon në atë letër se “kishte lajmëruar edhe Titon”. Sipas një raporti britanik, Kemp i u largua në fund të shkurtit me ndihmën e forcave partizane dhe të Hands, i cili vazhdoi dhe për një kohë veprimtarinë e tij si oficer ndërlihdës në Kosovë.

Informacionet për mbledhjen e Bujanit, memorandum i “Billy” Maklin, raportet e Hands dhe të Kemp për Kosovën, nxitën interesimin e Komitetit të Operacioneve Speciale, i cili kërkoi informacion më të plotë për rajonin. Shefi i seksionit shqiptar në Bari, SPM Lik, hartoi një material informativ dhe analitik për historinë e Kosovës, përbërjen etnike

---

<sup>29</sup> PRO. HS 5/68/B8/2/PL/232, Raport i SPM Lik, kryetar i seksionit shqiptar në Bari për Kajron, më 5 shkurt 1944, bazuar në informacionin e dërguar në Bari nga oficerët britanikë Hends e Kemp.

<sup>30</sup> PRO. HS 5/66/B8/2/PL/211, Telegram i SPM Lik, kryetar i seksionit shqiptar në Bari dërguar Kajros, më 1 janar 1944. Në telegram thuhet se oficeri Hends ka bërë një kërkesë urgjente dhe ka marrë leje për t'i dhënë 1000 stërlina partizanëve të Kosmetit. Deri tani i ka dhënë Kosmetit dy pagesa, secila 500 stërlina, në nëntor dhe në dhjetor 1943. Hends deklaroi se Kosmeti i ka shpenzuar këto shuma për mbajtjen e forcave ekzistuese dhe për të rekrutuar partizanë të rinj, për ushqime bazë, këpucë dhe veshje.

<sup>31</sup> PRO. HS 5/144, Peter Kemp, “Raport on Albania, August 1943- March 1944”.

<sup>32</sup> AQSH, F. 40, V. 1944, D. 25.

të popullsisë së saj, për rëndësinë strategjike, ekonomike dhe për forcat politike që vepronin aso kohe në të. Sipas SPM Lik, situata në Kosovë është “ekstremisht delikate”. Në raportin që i përcillej Kajros dhe seksionit jugosllav të Barit, SPM Lik parashtronte dhe disa rekomandime, si: partizanëve të Kosmetit t’u jepej ndihmë e kufizuar materiale dhe financiare, vetëm sa për të organizuar grupe të vogla për qëllime sabotazhi. Partizanët duhej të dekurajoheshin nga formimi i brigadave të mëdha, pasi ato kishin vlerë të vogël ushtarake dhe ndoshta do të përdreshin për qëllime të brendshme. Ndërsa me nacionalistët dhe irredentistët të mbaheshin kontakte vetëm për qëllime zbulimi e për propagandë subversive. Atyre nuk duhej t’u jepej asnjë mbështetje materiale me përjashtim të pagesave për agjentët dhe kontaktet individuale. Nacionalistët nuk do të thirren për të ndërmarrë asnjë veprimtari kundër gjermanëve deri në tërheqjen finale<sup>33</sup>. Më pas me kërkesën e SOC, majori SPM Lik u parashtrroi shefave të tij arsye më të detajuara përse duhej mbajtur lidhja me Kosovën, e si të tilla ai konsideronte mundësinë e evakuimit të personelit të SOE nëpërmjet Kosovës për në aeroportin e Beranes; pasuritë e minierave të kromit; mundësinë e përfshirjes së Kosovës për të goditur gjermanët gjatë tërheqjes në fund të luftës;<sup>34</sup> si dhe supozimin se shkëputja e kontakteve me Kosmetin do të bëjë një “përshtypje të papranueshme për partizanët jugosllavë”<sup>35</sup>. Është interesante se majori Lik parashikon “trazira serioze ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë pas largimit të gjermanëve”. Prandaj ai rekomandonte që koloneli Hends “të evakohet menjëherë nga rajoni i tij nëpërmjet territorit të kontrolluar nga partizanët jugosllavë, sapo gjermanët të tërhiqen nga Kosova”<sup>36</sup>.

Dokumentet britanike bëjnë me dije se në fund të janarit apo në fillim të shkurtit 1944, interesimi i SOC për Kosovën ra. Më 30 janar

<sup>33</sup> PRO. HS 5/79/B8/2/PL/178, “Kosovo Region”.

<sup>34</sup> PRO. HS 5/79/B8/12/PL/206, Telegram i SPM Lik dërguar Kajros, dhe B1 (seksioni jugosllav i Barit), më 29 janar 1944.

<sup>35</sup> PRO. HS 5/66/B8/2/PL/211, Telegram i SPM Lik dërguar Z. Steel, më 30 janar 1944. Në telegram thuhet se oficeri Hends ka bërë një kërkesë urgjente dhe ka marrë leje për t’i dhënë 1000 stërlina partizanëve të Kosmetit. Deri tani i ka dhënë Kosmetit dy pagesa, secila 500 stërlina, në nëntor dhe në dhjetor 1943. Hends deklaroi se Kosmeti i ka shpenzuar këto shuma për mbajtjen e forcave ekzistuese dhe për të rekrutuar partizanë të rinj, për ushqime bazë, këpucë dhe veshje.

<sup>36</sup> PRO. HS 5/68/B8/2/PL/232, “Liaison with the Kossovo-Metohija (Kosmet) Partisans”, 5 shkurt 1944.

1944, Zyra Strategjike e Kajros u dërgon kolonelit Hands dhe majorit Kemp këtë mesazh: “Mbani në mendje se ne nuk jemi të interesuar për operacionet jashtë kufijve të vjetër të Shqipërisë”<sup>37</sup>. Në këtë kohë, britanikët kishin braktisur Draža Mihajloviçin [Draža Mihailović] dhe e kishin përqendruar gjithë kujdesin te ushtria partizane e Titos dhe operacionet që do të kryente ajo. Qeveria britanike më në fund e kishte vendosur t’i jepte Titos ndihmë të pakufizuar.

Nga dokumentet duket qartë se nuk mund të kërkohej një qëndrim britanik për Kosovën, jashtë politikës britanike me Jugosllavinë, ku dhe Tito do të ishte aleati i vetëm. Në këtë kuadër kemi dy pamje:

- *Njëra pamje* është vështrimi i BLO në terren, të cilët kishin marrë porosi të mbështesnin grupet e rezistencës. Dhe në fakt, propozimet politike nga terreni ishin në funksion të kësaj detyre.

- *Pamja e dytë* janë vendimet politike të qeverisë britanike.

Oficerët ndërlidhës britanikë që vepronin në Kosovë apo edhe në Shqipëri nuk ishin në brendësi të strategjisë politike të qeverisë së tyre. Në të vërtetë, oficerët ndërlidhës në Shqipëri, e sidomos në Kosovë, e prekën konkretisht realitetin e hidhur etnik dhe e përcollën atë me besnikëri në qendër. Madje dhanë dhe alternativat e tyre në favor të një deklarate për një plebishit të lirë në Kosovë pas lufte. Por politikat nuk i bënin ata, politikat i bënte qeveria, madje edhe ajo në korrelacion me faktorë të tjerë ndërkombëtarë.

Projektet e Barit, të Kajros dhe të Londrës nuk mbështetën as nacionalistët e as partizanët shqiptarë në Kosovë. Për shefin e seksionit shqiptar të Barit, mbështetja e nacionalistëve shqiptarë kishte të ngjarë të krijonte “vështirësi me partizanët jugosllavë”, ndërsa mbështetja e partizanëve shqiptarë, kishte të ngjarë të prodhonte aksione të menjëhershme por në qoftë se zbatohej pa kujdes e pa seriozitetin e duhur, “do të prodhonte Luftë Civile”<sup>38</sup>. Kjo, sepse Kosova nuk ishte pjesë e interesave politike të Britanisë së Madhe. Dhe si e tillë as që pritej që çështja e saj të hidhej në tryezë diskutimi me Titon. Interesat ushtarakë të çastit, d.m.th. tërheqja e kosovarëve në luftë, ishin për t’u marrë në konsideratë, por jo në proporcion me rëndësinë që kishin interesat

<sup>37</sup> PRO. HS 5/66, Telegram i D. (Section D of the Secret Intelligence Service (S.I.S. Seksioni D i Shërbimit Sekret Inteligent) dërguar për Hends dhe Kemp.

<sup>38</sup> PRO. HS 5/79, Telegram i SPM Lik dërguar Kajros, më 21 janar 1944.

britanikë për shtabin komunist të Titos. Qeveria britanike i frikej një lufte civile dhe etnike në Kosovë, që do t'i krijonte shqetësime Titos.

### **Fundi i Luftës dhe “mbyllja” e çështjes së Kosovës**

PKJ dhe PKSh u përpoqën të kapnin pushtetin, pra të “zgjidhnin” formën e regjimit që në kohën e luftës dhe në një farë mënyre ia arritën qëllimit<sup>39</sup>. Në Jugosllavi dhe në Shqipëri u zgjodh nga një komitet antifashist me të gjitha atributet e një qeverie dhe iu ndalua si Mbretit Peter II, ashtu dhe Mbretit Zog të ktheheshin në atdheun e vet. Përsa u përket kufijve, në Konferencën e Paqes të Parisit, 1946, u diskutuan pretendimet greke për kufirin jugor të Shqipërisë, kurse kufiri verior me të cilin ishte e lidhur ngushtësisht çështja e Kosovës, nuk u shtrua për diskutim. Britanikët ndiqnin me vëmendje zhvillimet e ngjarjeve dhe sidomos marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi, që po bëheshin gjithmonë e më të afërta. Në nivelet e larta të politikës britanike diskutohet vazhdimisht për të ardhmen e Kosovës nëse në Jugosllavi e në Shqipëri fitojnë komunistët. Më 29 gusht 1944, një mision ushtarak jugosllav, me në krye kolonelin Velimir Stojnić [Stojnić] arriti në Shqipëri. Ai erdhi së bashku me përfaqësuesit e Shtabit UNÇSh, Ramadan Çitaku, Bedri Spahiu dhe Nesti Kerenxhi<sup>40</sup>, që kishin qenë për bisedime në shtabin e Titos. Nga informacionet e gjeneralit Fitzroy Maklin bëhet me dije se në shtypin e Beogradit ishin publikuar një varg artikujsh për Shqipërinë të shkruar nga koloneli Velimir Stojnić (më tej: Velimir Stojnić) dhe se prej tyre kuptohej qartë se “sistemi i ri ushtarak politik shqiptar nën Hoxhën

<sup>39</sup> Në mbledhjen e dytë të AVNOJ-t në Jajcë, 29 nëntor 1943, u morën vendime që ia ndalonin Mbretit Peter II kthimin në Jugosllavi. Po në atë mbledhje Këshilli Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë u sanksionua si trupi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv i vendit dhe u zgjodh një Komitet Nacional i Çlirimit të Jugosllavisë, si trupi që mbante të gjitha karakteristikat e një qeverie (Komiteti Nacional i Çlirimit të Jugosllavisë u zgjodh nga Presidenca e AVNOJ-t, në një mbledhje të veçantë të saj më 30 nëntor 1943). Po kështu ndodhi edhe në Kongresin e Përmetit, 24 maj 1944, ku Mbretit Zog I iu ndalua kthimi në Shqipëri, dhe, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) u sanksionua si trupi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv. Në mbledhjen e 26 majit 1944, KANÇ zgjodhi Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar “me atributet e një qeverie popullore provizore”.

<sup>40</sup> Nesti Kerenxhi, ishte nisur nga Shqipëria për të takuar Titon në Vis me detyra speciale nga vetë Enver Hoxha dhe Miladin Popović (më tej: Miladin Popović).

po vendoset deri në detajet më të vogla i njëllojtë me sistemin jugosllav të Titos”<sup>41</sup>.

Në muajt e fundit të vitit 1944, në nivelet e lartë të FO shprehej shqetësim për lidhjet e ngushta shqiptare-jugosllave dhe qarkullonte mendimi se “Hoxha është i angazhuar në bisedime me Titon rreth kufijve të Kosovës”. Ambasadori britanik pranë qeverisë greke në Athinë, kërkoi të verifikohet ky informacion. Sipas tij, nëse ka ndonjë marrëveshje për kufirin midis Titos dhe Hoxhës, “ka të ngjarë të jetë në bazë të ndonjë bashkimi ballkanik nën kujdesin e Titos. Dhe kjo mund të arrihet vetëm në kurriz të pavarësisë së Shqipërisë”<sup>42</sup>. Nga shkëmbimet e mesazheve, vëmë re se telegrami i Leeper, ambasadori britanik pranë qeverisë greke në Londër (1939-1944) dhe në Athinë (1944-1946) ka ngjallur diskutime në FO. Nga kabineti i ministrit të Jashtëm, Denis Laskey (më tej: Denis Laski) shprehet se qeveria partizane e Titos mund t’i lejonte Shqipërisë të mbante Kosovën. Por ajo mund të kërkonte si shpërblim që Shqipëria të hynte me ndonjë formë në Federatën e Sllavëve të Jugut. Sipas tij “një çmim i tillë ia vlente të paguhet nga Shqipëria”<sup>43</sup>. Megjithatë qëndrimet në FO nuk janë të njësuara. Në këndvështrimin britanik, interesat jugosllavë dhe ata grekë prevalojnë mbi interesat shqiptarë. Ka studime që e pranojnë shkëmbimin vullnetar të popullsisë, duke ardhur në Shqipëri shumë shqiptarë të Kosovës dhe grekët në Shqipërinë e Jugut të shkojnë në Greqi<sup>44</sup>. Të tjerë zyrtarë të lartë të FO e shikojnë me frikë bashkimin e Kosovës me Shqipërinë pasi “mund të drejtohet kundër Greqisë”<sup>45</sup>. Ndërsa diplomati Filip Broud, ministri rezident britanik në Kajro, mendon se nuk mund të njihnin përfshirjen e Kosovës në Shqipëri, pra kufijtë e vendosur në Luftë, përderisa nuk ishte përfunduar një marrëveshje mes Titos dhe Hoxhës<sup>46</sup>.

<sup>41</sup> PRO. FO 371/43560/R 21720/1042/90, Telegram i Gjeneral Fritzoy Maclean, Nr. 85, dërguar nga Beogradi për FO, më 24 tetor 1944.

<sup>42</sup> PRO. FO. 371/43554, Telegram Nr.1 i Reginald Leeper, ambasador britanik pranë qeverisë greke në Athinë, dërguar Barit, më 28 dhjetor 1944.

<sup>43</sup> PRO. FO 371/43566/R 17358/39a, Telegram i Denis Laskey, nëpunës në seksionin shqiptar në FO, Nr.1, dërguar Filip Broud në Kazerta, më 1 nëntor 1944.

<sup>44</sup> Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar, 1939-1949*, Tiranë: GEER, 2002, f. 446-465.

<sup>45</sup> PRO. FO 371/43566/R 21989/14079/a, Telegram i G.C.Cluton, dërguar Douglas E. Houard, kryetar i Departamentit të Jugut në FO, më 2 nëntor 1944.

<sup>46</sup> PRO. FO 371/43566/R 17358/39a, Telegram i Denis Laskey, nëpunës në seksionin shqiptar në FO, Nr.1, dërguar Filip Broud në Kazerta, më 1 nëntor 1944.

Deri më sot ende nuk janë të njohura bisedat që udhëheqësit e lartë politikë jugosllavë e shqiptarë kanë bërë mes tyre për Kosovën. Dihet vetëm se ka një vendim të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar të Shqipërisë që i konsideronte të “paqena” të gjitha ligjet e miratuara gjatë pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste dhe Gjermania naziste<sup>47</sup>. Këtu përfshiheshin edhe vendimet e ligjet për kufijtë e Shqipërisë. Gjithsesi, në fillim të vitit 1945, problemi i Kosovës midis udhëheqjeve të Jugosllavisë e Shqipërisë kishte përfunduar. Në fund të dhjetorit 1944, midis Shqipërisë e Jugosllavisë ishte nënshkruar një Traktat Aleance dhe Ndihme Reciproke, madje një nga firmëtarët është vetë Tito<sup>48</sup>. Por ratifikimi i tij u shty në kohë nga Stalini me argumentin e pritjes së vendimeve të Konferencës së Jaltës<sup>49</sup>. Pas një muaji, në shkurt 1945, Konferenca e Jaltës ashtu si marrëveshja e përqindjeve në Moskë në tetor 1944, nuk mori vendime të posaçme për Shqipërinë. Dhe kjo do të thoshte që statusi i Shqipërisë vazhdonte të mbetej i dobët dhe ndoshta i negociueshëm. Përsa i përket Traktatit të Aleancës dhe Ndihmës Reciproke midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, të dy qeveritë duhet ta kenë konsideruar të paqenë përderisa nuk iu referuan asnjëherë në vitet e mëvonshme.

Regjistrimet britanike për Kosovën në fillim të vitit 1945, flasin për vendosjen e Administratës Ushtarake në Kosovë, për mobilizimin e meshkujve shqiptarë kosovarë nga 16-60 vjeç, për masakrën e Tivarit e deri tek aneksimi i Kosovës, Serbisë. Siç dihet, në Kosovë nuk pati plebishit për kufijtë. Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, në mbledhjen e tij të dytë në korrik 1945, vendosi aneksimin e Kosovës-Serbisë. Dokumenti për këtë vendim i duhej Titos për ta

<sup>47</sup> *Gazeta Zyrtare*, Viti II, Nr. 12, 22 maj 1945. Ligji 61, i miratuar më 17 maj 1945. “Mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promolguara gjatë okupacionit të huaj mbi pavlefshmëninë e vendimeve penale të dhëna gjatë asaj kohe prej autoriteteve ushtarake dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore që ishin para datës 7 prill 1939”. Neni 1 i Ligjit 61 sanksionon: “Statutet, ligjet, dekret/ligjet, rregulloret dhe dekretet e promolguara gjatë kohës së okupacionit italian dhe gjerman abrogohen dhe deklarohen të paqëna”.

<sup>48</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* [më tej: *AMPJ*], V. 1945, D. 1, “Traktat mbi Aleancën dhe Ndihmën Mutuale midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë”.

<sup>49</sup> Shih Ana Lalaj, “Mjegulla për Federatën dhe pavarësia e rrezikuar”, *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, Universiteti i Tiranës dhe Instituti i Historisë, Tiranë: “KLEAN”, 2008, f 367.

reklamuar brenda dhe jashtë Jugosllavisë si shprehje e vullnetit të popullit të Kosovës. Dokumentet britanike kanë fiksuar procedurat manipuluese të ndjekura nga Beogradi për këtë aneksim, që nga mbledhja e parë e ASNOS (më tej: Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Serbisë), 7-9 prill 1945, tek lajmi që Radio Beogradi dha më 10 prill 1945, ora 13.30 e deri tek heshtja e Këshillit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë. Në një raport të Misionit Ushtarak Britanik [British Military Mission - BMM] në maj 1945, shkruhet: “Lajmi që Kosova është përfundimisht pjesë e Federatës së Jugosllavisë ka filluar të bëhet gjerësisht i njohur, pavarësisht nga heshtja e FNÇ për këtë çështje. Fakti që FNÇ ra dakord për humbjen e këtij rajoni vital me popullsinë e tij mbizotëruese shqiptare konfirmon se si është shitur tërësisht FNÇ te Jugosllavia dhe ka larguar të gjithë elementët nacionalistë, veçanërisht në veri të vendit dhe akoma më tutje”<sup>50</sup>. Sigurisht kjo heshtje dëshmon për dobësinë e qeverisë shqiptare për të përballuar një reagim të opinionit popullor vendas. Madje një anëtar i stafit të Misionit Ushtarak Jugosllav do të shprehej se “Koha nuk është pjekur”<sup>51</sup> që popullit shqiptar t’i bëhej i njohur vendimi për përfshirjen e Kosovës në Serbi.

Për Titon, problemi i Kosovës quhej i mbyllur, madje në marrëveshje të plotë me qeverinë shqiptare. Ai kishte filluar punën për projektin e Federatës Ballkanike, ku do të përfshinte Bullgarinë por edhe Shqipërinë. Kosova nuk kishte fare të bënte me këtë projekt, me apo pa Federatë, ajo do të mbetej në Jugosllavi. Çmimi që pagoi qeveria shqiptare nuk ishte Kosova, siç e parashikonin diplomatët e politikanët e lartë britanikë, në fund të luftës dhe menjëherë pas saj në ankand ishte vënë gjithë Shqipëria.

Kosova brenda apo jashtë shtetit shqiptar ka qenë dilemë, që diplomacia britanike dhe evropiane e ka mbajtur në sirtarët e saj. Lufta e Dytë Botërore ishte një çast i mundshëm për zgjidhje, në të mirë të të gjithë shqiptarëve. Por, interesat e ndryshëm të vendimmarrësve të mëdhenj, si dhe dobësitë e statusit të vetë shtetit shqiptar, gjatë dhe në fund të Luftës, e penguan zgjidhjen e aspiratës kombëtare dhe legjitime për vetëvendosje. “Vezët” e Versajës u mbuluan nga “hiri” i Jaltës dhe më 1999, Kosova ishte e fundit që u largua nga Federata e shpërbërë,

<sup>50</sup> PRO, HS 5/54, BMM 101/5, Periodical Political Report, Nr.3, dt. 22 maj 1945.

<sup>51</sup> PRO, HS 5/54, BMM 101/8, Periodical Political Report, Nr.6, dt. 22 qershor 1945.

megjithëse historikisht ka qenë e para dhe disa herë radhazi e vetme, që ka artikuluar vendosmërisht të drejtën e saj për shkëputje.

### *S u m m a r y*

#### THE BRITISH DILEMMA ON KOSOVË: INSIDE OR OUTSIDE THE ALBANIAN STATE (1941-1945)

During World War II concern on the solution of the Kosovë issue was forwarded to the British Liaison Officers in Albania from entire Albanian political spectrum, from citizens of different regions and of different cultural levels. All of them demanded the British Liaison Officers that the Allied governments release a statement, where to say that "Kosovë's future would be decided by a plebiscite held under Allied supervision." Liaison officers in Albania, especially in Kosovë, touched by themselves the bitter ethnic legacy and its impact on political reality in Kosovë and forwarded it faithfully to their center in Bari giving their alternatives in favor of a plebiscite statement. But they were not policy-makers. The British Liaison Officers were not inside the political strategy of His Majesty Government. Special Operations Committee (SOC), a committee which examined important political and military issues of the struggle in the Balkans, rejected the request come from Liaison Officers in Albania. The reason was that Kosovë was not priority of the British policy.

The British attitude to Kosovë, should be seen in the context of British policy to Yugoslavia. Instant military interests, namely the participation of Kosovars in the war, were taken into consideration, but the importance of British interests towards Tito's communist Headquarters was greater. Therefore His Majesty government did support neither Kosovar partisans nor nationalists for the big operations beyond the old frontier of Albania. It was afraid of a civil and ethnic war in Kosovë, which would create concerns to Tito. In these circumstances it was not expected that the Kosovë issue to be thrown on a roundtable discussion with Tito.

On the other hand, the British documents discover that no declaration was released by Tito for a plebiscite of Albanians in Kosovë, which would be realized once the war ended. That was a false statement widespread by Tito's Headquarter to devaluate the German propaganda that Kosovë will be remain within Yugoslavia after the WWII.